

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"Skyline Call" shpk

Neni 1 – Emertimi

1.1 Emertimi i shoqerise eshte "Skyline Call", me poshte eshte quajtur "Shoqeria".

Neni 2 –Personaliteti juridik

2.1 Shoqeria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar, prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Neni 3 – Selia

3.1 Selia e Shoqerise është në adresën: Njesia bashkiake nr.8, rruga e Dibres, ZK 8370, nr.pasurie 10/276+2-N8, Tirane, Shqipëri.

3.2 Shoqeria mund te hape dhe mbaje zyra dhe/ose te kryeje aktivitete ne vende te tjera, brenda ose jashte Republikes se Shqiperise si dhe te hape ose mbylle zyra ne vende te ndryshme pervec selise se Shoqerise.

Neni 4 – Kohezgjatja

4.1 Kohezgjatja e Shoqerise eshte per nje periudhe kohore te pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Neni 5 – Objekti

5.1 Objekti i Shoqerise eshte:

Sherbime Marketingu online, qender telefonie informatike. Aktivitet ne fushen e ofrimit te sherbimeve te ndryshme online; "telefonata ne Web"; Aktivitet kerkimor, perzgjedhje, orientim, trajnim dhe aktivitete menaxheriale dhe profesionale trajnimi me sisteme multimediale dhe sisteme ne largesi; Aktivitet ne fushen e organizimit te seminareve, takime, konferenca, organizime te pergjithshme dhe aktiviteteve te promovimit te imazhit. Aktivitet ne fushen e marketingut ne web. Aktivitet ne fushen e tregtise elektronike edhe per llogari te paleve te treta; Prodhimin, marketingun dhe rishitjen e energjise elektrike te perftuar nga burime alternative pa kufizime territoriale, te sherbimeve te komunikimit qe rrjedhin nga zhvillimi i teknologjive; Perdorimi i sistemeve kompjuterike ne fushen e studimit dhe kontrollit, Perdorimi i sistemeve te informacionit territorial 2(GIS). Call center hyres dhe dales; Shoqeria mund te marre pjese ne cilesine e ortakut apo te aksionerit ne shoqeri te tjera tregtare me objekt te njejte ose te ndryshem. Ne perputhje me legjislacionin Shqiptar, ne menyre qe te arrije objektin e lartpermendur, shoqeria mundet gjithashtu te kryeje çdo transaksion lidhur me asetet e luajtshme ose pasurite e paluajtshme, vendosja e pengjeve, hipotekes, barreve si dhe aktivitete te cilat mund te konsiderohen te nevojshme per te arritur aktivitetin e Shoqerise. Gjithashtu shoqeria mund te kryeje aktivitete te tjera te cilat nuk ndalohen nga ligji ne fuqi, te vlefshme dhe me interes per Shoqerine, me ane te pajisjes me licencat e nevojshme, zhvillim aplikacionesh kompjuterike, per software, crm, mbrojtje te dhenash database, promocion, telemarketing,

Arander B9/18



1

MINARDO GASPARI



shërbime telefonike, shërbime asistence online. Ndermjetesim ne turizem dentar dhe guida turistike. Hr solution, online dhe terren, import, export, inteligjenca artificiale, kerkime online, medical turizem, konsulence investimesh, bërjen e fushatave publicitare dhe të tjera shërbime reklamuese me qëllim tërheqjen dhe mbajtjen e klientëve, aktivitete të marrdhënieve publike dhe të komunikimit.

Neni 6 – Kapitali i Shoqërisë

6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është ne vlerën 100,000 leke i ndarë në 2 pjesë, me vlerë nominale:

- 50,000 lekë 1 pjesë e cila zoterohet nga shoqëria “Maxima Consulting” me nipt M32613202P
- 50.000 leke 1 pjesë e cila zoterohet nga shoqëria “Global Marketing” shpk me nipt M31704034T.

Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe shlyer në tërësi nga ortakët themelues.

6.2 Kapitali i Shoqërisë perbehet teresisht nga kontribute ne para dhe zoterohet ne teresi nga ortakët e Shoqërisë:

- Shoqëria “Maxima Consulting” me nipt M32613202P me adrese ne Elbasan lagjja “Luigj Gurakuqi”, bulevardi Aqif Pasha, zona kadastrale nr.8521, kati 2, godina e hotel Skampa, Elbasan, Shqiperi perfaqesuar nga Z.Skënder Balla, i biri i Rrapush dhe i Gushi, i dtl. 08.04.1988, lindur ne Elbasan dhe banues në Elbasan, lagjja “Partizani”, rruga “Mustafa Skuqi”, pallati nr.413/2, mbajtës i pashaportes me nr.BF2577858 me nr.personal I80408020N, e cila zoteron 50% te kapitalit.
- Shoqëria “Global Marketing” shpk me nipt M31704034T me adrese ne Tirane Tirane Njesia bashkiake Nr.5 ,Bulevardi Bajram Curri.Zona Kadastrale 8260,P.2,H.1, Tirane perfaqesuar nga Z.Minardo Gaspari, i biri i Vangjo, lindur ne Elbasan me date 30.11.1981 dhe banues ne rrugen e Kavajes, P.126, Ap.11 Tirane, identifikuar me pasaporte nr. BC5917069 dhe nr.personal I1130084R, e cila zoteron 50% te kapitalit.

Neni 7 – Zmadhimi i kapitalit

7.1 Zmadhimi i kapitalit behet me vendim te Ortakeve.

7.2 Zmadhimi i kapitalit mund te behet me derdhje ne para ose me kontribute ne natyre. Ne çdo rast keto kontribute duhet te shoqerohen me nje çertifikate per nenshkrimin e tyre ose nje raport vleresimi te kontributeve te kryer nga nje ekspert i vleresimit te kontributeve ne natyre.

Neni 8 – Zvogëlimi i kapitalit

8.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet me vendim të Ortakeve me propozim të Administratorit, vetëm në rastin kur Shoqëria mund të pësojë humbje të tilla që ta bëjnë të domosdoshëm këtë zvogëlim.

Skënder Balla



2

MINARDO GASPARI



Neni 9 - Transferimi i kuotave

9.1 Ortaket mund të vendosin për transferimin e kuotave të kapitalit të Shoqërisë nëpërmjet shitjes, trashëgimisë, dhurimit ose në çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga ligji personave të tjerë në çdo kohë.

Neni 10 - Kompetencat e Ortakëve

10.1 Ortakët, në përputhje me legjislacionin shqiptar, mund të marrin, por pa u kufizuar vetëm në to, vendime për ndryshimin e Statutit, bashkimin me shoqëri të tjera, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, transferimin e plotë ose të pjesshëm të kuotave, emërimin dhe shkarkimin e administratorit, emërimin e ekspertit kontabël, miratimin e llogarive vjetore dhe të pasqyrave financiare, likuidimin e Shoqërisë, emërimin e likuidatorit(ëve).

Neni 11 - Administratori

11.1 Administratori i parë i Shoqërisë është:

- 1 Z.Skënder Balla, i biri i Rrapush dhe i Gushi, i dtl. 08.04.1988, lindur ne Elbasan dhe banues në Elbasan, lagjja "Partizani", rruga "Mustafa Skuqi", pallati nr.413/2, mbajtës i pashaportes me nr.BF2577858 me nr.personal I80408020N.

11.2 Administratori emërohet me vendim të Ortakëve dhe do te qëndrojë në detyrë për një afat 5 (pesë) vjeçar. Administratorët mund të rizgjidhen për të njëjtin afat në bazë të vendimit të Ortakeve ose siç parashikohet në dispozitat ligjore.

11.3 Në rast të dy ose më shumë Administratorëve, Ortakët mund të marrin vendime për kryerjen e kompetencave dhe detyrave nga Administratorët, veç e veç ose së bashku.

11.4 Administratorët mund të shkarkohen nga detyra në çdo kohë me vendim të Ortakëve dhe/ose sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 12 - Kompetencat e Administratorit

12.1 Administratori është përgjegjës për çështjet e përditshme të Shoqërisë dhe përfaqëson Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët në përputhje me dispozitat e Statutit dhe/ose ligjit të zbatueshëm.

12.2 Administratori ka kompetencat dhe detyrat e mëposhtme:

- a) mbikqyr dhe zbaton politikën e biznesit të Shoqërisë;
- b) përfaqëson Shoqërinë;
- c) kujdeset që Shoqëria të zbatojë ligjet dhe standardet e mbajtjes së llogarive;
- d) përgatit dhe nënshkruan bilancin dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe ia paraqet Ortakeve për miratim;
- e) siguron që deklaratat e llogarive vjetore si dhe raporti i ecurisë së biznesit dhe çdo deklaram tjetër i detyrueshëm sipas ligjit ose statutit, janë bërë siç duhet;
- f) siguron që auditimi i librave dhe i të dhënave kryhet të paktën një herë në vit nga ekspertë kontabël të certifikuar;
- g) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- h) kryen çdo detyrë tjetër të caktuar nga ligji ose statuti.

Neni 13 - Viti ushtrimor financiar

13.1 Viti ushtrimor financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

3

MINARDO GASPARI

Skënder Balla



Neni 14 - Shpërndarja/likuidimi

14.1 Për shpërndarjen e Shoqërisë, në çdo kohë dhe për çdo arsye, si dhe për likuidimin dhe për emërimin e likuidatorëve, do të vendoset sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 15 - Baza ligjore

15.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe me legjislacionin shqiptar.

15.2 Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut, do të aplikohen normat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare dhe në veçanti të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

15.3 Çdo konflikt që mund të lindë në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e këtij Statuti, si dhe çdo konflikt që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, në rastet e përgjegjshmërisë, dhe raste të tjera, do të jetë objekt i zgjidhjes nëpërmjet vendimit të gjykatave shqiptare.

Neni 16 - Ndryshimet

16.1 Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose i tëri dhe të zëvendësohet me një statut të ri me vendim të Ortakëve.

16.2 Ky Statut është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe .

Nënshkruar sot më datë 23.06.2023 nga:

ORTAKËT

Shoqëria "Maxima Consulting"

Z. Skënder Balla

Skënder Balla



Shoqëria "Global Marketing"

Z. Minardo Gaspari

MINARDO GASPARI

